



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs
Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police



STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT

I LEËBIVIT
DHE YGVI
SHTETËSIA



POLICIA E UDHËHEQUR NGA INTELIGJENCA

PËRMBAJTJA

I. HYRJE	4
a) Participimi (Pjesëmarrje).....	4
b) Implementimi i standardeve.....	4
c) Trajnimet.....	4
d) Menaxhmenti.....	5
II. BAZA LIGJORE	5
III. SITUATA AKTUALE	5
IV. VIZIONI DHE MISIONI	6
V. PARIMET E PERGJITHSHME	7
VI. MEKANIZMAT PËR IMPLEMENTIM	7
VII. STRUKTURA ORGANIZATIVE E EKIPIT TË PROJEKTIT	8
VIII. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	9
IX. OBJEKTIVAT SPECIFIKE	9
X. MONITORIMI DHE VLERËSIMI	10
XI. PLANI I VEPRIMIT	11

SHKURTESAT

PK-	Policia e Kosovës.
PUI-	Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca.
MPB-	Ministria e Puneve të Brendshme.
CD&K-	Grupet për Caktimin e Detyrave dhe Koordinim.
PSO-	Procedura Standarde e Operimit.
TI-	Teknologjisë Informative.
EULEX-	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
IP-	Inteligjenca Policore.
OSCE-	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë.
ICITAP-	Programi për ndihmë ndërkombëtare ne trajnim për hetim të krimit.

I. HYRJE

Qëllimi i kësaj strategjie dhe planit të veprimit është implementimi i modelit Polici e udhëhequr nga Inteligjenca në Policinë e Kosovës.

Ky model është praktikë e organizatave policore në vendet e zhvilluara dhe paraqet një model i cili kombinon praktikën më të mirë të aktivitetëve policore. Implementimi i këtij modeli në Policinë e Kosovës të besueshme dhe me potencial të mjaftueshëm për përmbushjen e misionit të vet dhe për bashkëpunim profesional me organizatat policore të vendeve të tjera.

Modeli Polici e Udhëhequr nga Inteligjenca do të mundësojë Policisë së Kosovës që në vend të metodave tradicionale të policisë reaktive të aplikojë metoda bashkëkohore të policisë pro-aktive. Kjo do të mundësojë një vëmendje të shtuar ndaj krimineleve më aktiv, zhvillimin e strategjive për të parandaluar aktivitetet e tyre kriminale duke arritur maksimumin e rezultateve me resurset në dispozicion. Mbi të gjitha, puna e inteligjencës është proces i cili rezulton me raportet dhe produktet analitike të cilat ndikojnë në marrjen e vendimeve në planifikimin dhe ekzekutimin e operacioneve policore.

Inteligjenca është kërkesë kryesore në të gjitha fushat e policisë duke filluar nga krimet e nivelit të ulët që përfshijnë policinë në komunitet dhe çështjet e rendit publik deri tek çështjet e krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Puna e inteligjencës është një proces që rezulton me dhënien e produkteve kryesore të cilat do të ndihmojnë dhe ndikojnë në procesin e vendimmarrjes dhe planifikimit për operacionet e policisë.

Një strukturë efektive e inteligjencës kriminale do t'ju mundësojë menaxhereve të policisë të fokusohen në hartimin e planeve në bashkëpunimin dhe në interes të komunitetit të cilit i shërbejnë.

a) Participimi (Pjesëmarrje)

Kërkohet participim (pjesëmarrje) i përkushtuar i të gjithë pjesëtarëve të policisë prej zyrtarëve policor deri te strukturat më të larta. Përveç kontributit aktiv të të gjithë pjesëtarëve kjo nënkupton edhe njohuritë për funksionimin e sistemit të inteligjencës drejt arritjes së rezultateve, dhe si këto rezultate do reflektojnë në parandalimin dhe luftimin e krimit, forcimin si dhe zhvillimin e metodave efektive policore.

b) Implementimi i standardeve

Në të gjitha nivelet e organizimit përfshirë nivelin lokal dhe atë qendror do të implementohen standardet e njëjta në procedimin e inteligjencës.

c) Trajnimet

Është thelbësore që i gjithë stafi i policisë të kenë kryerë trajnime adekuata në pajtim me funksionin e rolin e tyre të veçante. Kjo do të përfshinte trajnime duke filluar prej zyrtarëve policor patrullues deri tek zyrtarët e specializuar të inteligjencës dhe menaxheret e lartë policor.

Trajnimi dhe edukimi i të gjithë policëve të Kosovës dhe zbatimi i PUI do të ndihmojë në zhvillimin e qasjes pro-aktive në polici.

d) Menaxhmenti

Menaxheret policor të të gjitha niveleve duhet të marrin njohuri për përparësitë e Modelit të Inteligjencës në marrjen e vendimeve strategjike, operative dhe taktike duke përdorur raportet dhe produktet analitike të inteligjencës.

Grupet për Caktimin e Detyrave dhe Koordinim (CD&K) në të dy nivelet, si në atë strategjik ashtu dhe atë taktik janë mjete kyçe për të siguruar paraqitjen e rezultateve të PUI-se.

II. BAZA LIGJORE

Për implementimin e PUI-së është e domosdoshme ekzistimi i bazës ligjore adekuate. Kosova ka një bazë të gjere ligjore për implementimin e PUI , duke filluar por duke mos u kufizuar vetëm në:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës
- Ligji Penal
- Ligji i Procedurës Penale
- Ligji i Policisë së Kosovës
- Aktet tjera nënligjore
- Konventat dhe aktet tjera Ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë
- Projektligji për mbrojtjen e të dhënave
- Projektligji për klasifikimin e informacionit

III. SITUATA AKTUALE

Metodologjia aktuale për mbledhjen e informatave nuk është adekuate. Zyrtarët policor nuk janë të trajnuar se si të mbledhin informata. Gjithashtu ekziston edhe mungesa e besimit publik, mungesa e mekanizmave të sigurisë për siguruesit e informatave si dhe besimi i ulët ndërmjet kolegëve e cila negativisht ndikon në furnizimin e njësisë së inteligjencës me informata.

Bashkëpunimi me institucionet tjera shtetërore për shkëmbimin e informatave nuk është i zhvilluar mirë, dhe nuk ka mundësi të qasjes në të dhëna nga institucionet tjera në këtë periudhë. Arsyet janë mungesa e pajisjeve teknike dhe dispozitave ligjore. Ekziston edhe një problem i ngjashëm me qasjen e kufizuar në ente legale, si kompanitë telefonike dhe bankat.

Reagimet e dobëta nga hetimet e krimeve janë problem tjetër pasi që hetimet mund të përfshijnë informata të rëndësishme në lidhje me mënyrën e veprimit, personat e përfshirë etj, që mund të jetë e vlefshme për qëllimet e inteligjencës.

Kemi një numër pengesash në analizimin e të dhënave. Ekziston mungesa e analistëve të specializuar operativ për ta kryer punën. Gjithashtu problem janë edhe të dhënat e shkapërderdhura pasi që nuk ekziston ndonjë data-bazë qendrore si dhe mungesa e softuerit përkatës mbi analizimin e të dhënave.

Nënvizimi i arsyeve për shumë probleme të përshkruara gjer tash është se modeli për aktivitete policore bazuar në inteligjencë ende nuk është përshtatur. Modeli duhet ta përshkruaj strukturën, proceset dhe procedurat për një mënyrë racionale dhe sistematike të trajtimit të informatave dhe sistemimit të burimeve.

Mungesa e modelit mirë të definuar është arsye tjetër për mungesën e një strategjie dokumentuese mbi analizat e rrezikut e cila si pasojë shpjen në vështirësitë në përcaktimin e prioriteteve në punën e inteligjencës. Prioritetet e definuar janë parakushte për mbledhje efikase dhe të efektshme të informatave dhe prekin gjithë ciklin e inteligjencës.

Sistemi aktual i sistemimit të personelit dhe mungesa e trajnimeve të përhershme shpjen në shfrytëzimin jo efektiv të burimeve ekzistuese. Stabiliteti i dobët dhe siguria e personelit është arsye tjetër për jo efikasitet dhe gjithashtu negativisht ndikon mbi motivimin. Masat për përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore duhet t'i adresohen këtyre problemeve.

Informata ekzistuese në data-bazën e inteligjencës nuk shfrytëzohen në mënyrë frekvente nga njësitë tjera brenda policisë.

Ekziston mungesa e njohurisë dhe diturisë në organizatën policore në lidhje me potencialin e njësisë së inteligjencës.

Përdorimi i raporteve të inteligjencës dhe produkteve analitike në vendimmarrje dhe planifikim gjithashtu është një mangësi me të cilën përballet sot PK-ja.

IV. VIZIONI DHE MISIONI

Vizioni

Krijimi dhe implementimi i një sistemi unik dhe efektiv të inteligjencës policore sipas standardeve më të larta ndërkombëtare.

Misioni

Misioni është zhvillimi dhe implementimi një sistem të vetëm dhe të qëndrueshëm të inteligjencës policore, që do të ishte në nivelin e standardeve ndërkombëtare të modelit të Policisë së udhëhequr nga Inteligjenca.

Ky sistem i mundëson Policisë së Kosovës që përmes shfrytëzimit të burimeve të saja të inteligjencës të jetë më efikase në ofrimin e një ambienti sa më të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës, duke filluar nga çështjet e sigurisë publike e deri tek krimi i organizuar, duke përmbushur objektivat e parapara sipas ligjit mbi Policinë të Republikës së Kosovës.

V. PARIMET E PERGJITHSHME

Parimi i Prioritetit - Parandalimi dhe luftimi i të gjitha formave të krimit, ruajtja e rendit dhe qetësisë publike është prioritet për institucionet e Kosovës. Policia e Kosovës do të jetë e përkushtuar në shfrytëzimin e burimeve të inteligjencës në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që ka.

Parimi i Profesionalizmit - nënkupton që zbatimimi i kësaj Strategjie kërkon ekspert të mirë, shkëmbim të përvojave, mjetet të përshtatshme si dhe praktika me të mira. Kjo nënkupton kombinim të trajnimit, edukimit dhe zhvillimit profesional për Policinë e Kosovës si dhe përkujdesjen për të rekrutuar vetëm specialistet e cilësisë me të lartë.

Parimi i Vazhdimësisë – aktivitetet duhet të shihen si pjesë e një strategjie të vazhdueshme. Kjo është sidomos e rëndësishme për arsye se do të ekzistojnë kufizimet kohore administrative /procedurale si dhe për arsye se iniciativat /aktivitetet e ndryshme do të jetë e nevojshme të ndërliken në veprime të cilat do të zgjasin me vite të tëra.

Parimi i Ligjshmërisë – Veprimet që duhet të ndërmerren në implementimin e kësaj Strategjie duhet të jenë në pajtueshmëri të plotë me Kushtetutën, ligjet dhe gjitha akteve tjera normative, vendore dhe ndërkombëtare të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Parimi i Besueshmërisë – i tërë personeli i Policisë së Kosovës, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi janë të përfshirë në procesin e Inteligjencës Policore duhet të kenë njohuri dhe përkushtim në ruajtjen e fshehtësisë. Të gjitha të dhënat e Inteligjencës Policore duhet të ruhen në një sistem të mbrojtur nga qasjet të paautorizuara.

I tërë personeli i PK-se duhet të kalojë përmes procedurave të verifikimit të sigurisë varësisht nga pozita e tyre përkatëse.

Parimi i Koordinimit dhe bashkëpunimit – të gjithë pjesëmarrësit duhet të përpiqen të krijojnë një qasje të unifikuar, duke i marrë parasysh të gjithë sektorët që mund të kenë ndikim në parandalimin dhe luftimin e krimit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar – Policia e Kosovës gjatë zbatimit të kësaj strategjie do të jetë e përkushtuar në bashkëpunim dhe bashkërendim të aktiviteteve policore në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar. Policia e Kosovës duhet të bëhet partnere profesionale e bashkëpunimit rajonal / ndërkombëtar.

Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut - Ky parim nënkupton garantimin e lirive dhe të drejtave të gjithë individëve, gjatë të gjitha fazave të implementimit të strategjisë PUI.

VI. MEKANIZMAT PËR IMPLEMENTIM

Nënkupton mekanizmat që kanë rol, rendësi dhe përgjegjësi në implementimin e këtij projekti.

Koordinatori

Koordinatori është personi përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të aktiviteteve, procedurave të parapara në planin e veprimit.


Departamenti Trajnimeve – identifikim e trajnimeve adekuate dhe realizimin e tyre si dhe rishikimin e plane programeve aktuale me qëllim të realizimit me sukses të kësaj strategjie.

Departamenti i Personelit – Do të përkujdesët për alokimin e burimeve njerëzor të nevojshme për implementimin e kësaj Strategjie, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi si dhe përfshirja e kontributit në procesin e inteligjencës gjatë vlerësimit të performancës të çdo zyrtari policor.

Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse – Krijimi i kushteve të domosdoshme përmes ofrimit të infrastrukturës fizike (hapësirave të punës) teknike dhe teknologjike si dhe burimeve tjera materiale.

Departamenti i IT – sigurimi i një infrastrukture fizike të qëndrueshme të teknologjisë informative si dhe krijimi i një sistemi informativ të integruar të të dhënave të PK-se që do të mbështesë implementimin dhe funksionimin e modelit PUI.

VII. STRUKTURA ORGANIZATIVE E EKIPIT TË PROJEKTIT



VIII. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

1. Fuqizimi i performances ne procesimin e informatave/inteligjencës nga pjesëtarët e PK-se.
2. Krijimi, implementimi dhe funksionalizimi i një sistemi unik te qëndrueshëm dhe efektiv te inteligjencës policore. mbledhjes dhe analizës se inteligjencës.
3. Përdorimi i raporteve dhe produkteve analitike te inteligjencës nga menaxherët e PK-se.
4. Ngritja e kapaciteteve te sistemeve informative ne kuadër te PK.
5. Rishikimi dhe përshtatja e strukturës organizative.
6. Plotësimi i infrastrukturës ligjore.
7. Menaxhimi i çështjet se sigurisë
8. Forcimi i bashkëpunimit me komunitetin dhe agjencionet tjera partnere

IX. OBJEKTIVAT SPECIFIKE

- 1.1 Prezantimi dhe promovimi i modelit PUI.
- 1.2 Planifikimi dhe organizimi i trajnimeve.

- 2.1 Rishikimi, harmonizimi, plotësimi dhe hartimi i PSO.
- 2.2 Rishikimi dhe plotësimi i përshkrimit te vendeve te punës ne pajtim me modelin PUI.
- 2.3 Identifikimi i Drejtorisë për Analize dhe Inteligjence si qendër e procesimit te inteligjencës policore.

- 3.1 Prezantimi dhe promovimi i produkteve analitike te inteligjencës për menaxhmentin e policisë.
- 3.2 Nxjerrja (përpilimi) e produkteve analitike te inteligjencës.
Caktimin e Grupeve CD&K

- 4.1 Rishikimi dhe vlerësimi i sistemit aktual të TI.
- 4.2 Fuqizimi i infrastrukturës se tanishme se teknologjisë informative.
- 4.3 Përmirësimin i sistemit informative se PK.
- 4.4 Avancimi i bazës se te dhënave te analizës se inteligjencës kriminale.

- 5.1 Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese te inteligjencës policore.
- 5.2 Propozimet për Strukturën Organizative te PK.

- 6.1 Propozimi për ndryshim dhe plotësim te infrastrukturës ligjore.

- 7.1 Siguria e personelit
- 7.2 Siguria e infrastrukturës fizike
- 7.3 Siguria e Teknologjisë Informative

- 8.1 Përfshirja dhe sigurimi i përkrahjes aktive nga publiku
- 8.2 Fuqizimi i bashkëpunimit me agjencitë partnere

X. MONITORIMI DHE VLERSIMI

Zbatimi

Implementimi i plotë i projektit “Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca” është planifikuar të realizohet në një periudhë kohore tri vjeçare, duke filluar nga data e aprovimit, ndërsa koordinatori i Projektit do të koordinojë aktivitetet e të gjitha grupeve punuese në implementimin e tij.

Monitorimi

Implementimi i projektit do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme si nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe përfaqësuesve të misionit të EULEX-it. Procesi i monitorimit do të përfshijë inspektimin dhe auditimin e vazhdueshëm në të gjitha fazat e implementimit.

Në përputhje me mandatin që e ka dhe përmes punës që e bënë në qasjen programatike, me ekipet për zbatimin e “action fiche”, EULEX-i do të vazhdojë me zhvillimin e aktiviteteve dhe detyrave kryesore, duke bërë njëheritë edhe mentorim, monitorim dhe këshillim lidhur me përparimin e zbatimit të projektit të PUI-se

Vlerësimi

Vlerësimi i Strategjisë do të bëhet në periudha të caktuara kohore mbi progresin e arritur dhe pengesave eventuale që mund të paraqiten gjatë implementimit të tij.

Detyrat specifike dhe veprimet konkrete mbi implementimin e strategjisë përfshirë edhe afatet kohore, si dhe planifikimi buxhetor janë të parapara në planin e veprimit të bashkangjitur kësaj strategjie.

XI. PLANI I VEPRIMIT

Plani i Veprimit është pjesë integrale e Strategjisë dhe hartohet Brenda kornizës së përgjithshme strategjike të përcaktuar me strategjinë Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca.

Plani veprimit për zbatimin e kësaj strategjie do të përmbajë:

1. Objektivat e strategjike;
2. Objektivat specifike;
3. Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave;
4. Përcaktoj Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv dhe aktivitet;
5. Saktësoj afatet kohore për realizimin e secilit objektiv;
6. Përcakton burimet e nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve.
7. Përcakton indikatorët apo treguesit për realizimin e secilit objektiv dhe aktivitet.

Plani i veprimit duhet të tregoj lidhshmëri me Kornizën e përgjithshme të kësaj Strategjie.